



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. __, datë ____/____/2026

PËR

**MASËN E PAGESËS PËR FAMILJEN KUJDESTARE DHE PËR FËMIJËT E
VENDOSUR NË KUJDES ALTERNATIV NË FAMILJE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 31, pika 3 të ligjit nr. 92/2025, "Për kujdesin alternativ në familje në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit përgjegjës për çështjet sociale, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

Neni 1

Llojet e mbështetjes financiare

Mbështetja financiare sipas këtij vendimi përfshin:

- mbështetje mujore për familjen kujdestare profesionale;
- mbështetje mujore për shpenzimet e fëmijës së vendosur në kujdes alternativ në familje;
- mbështetje vjetore për shpenzime të tjera sipas nevojave të fëmijës.

Neni 2

Financimi për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje

- Financimi për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje përfshin:
 - mbështetjen financiare mujore për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje për përmbushjen e nevojave të jetesës së tyre të përditshme, në masën 12.000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në muaj;
 - mbështetjen financiare vjetore për çdo fëmijë të vendosur në kujdes alternativ në familje, për përballimin e shpenzimeve të tjera sipas nevojave të fëmijës, në masën 35.000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë në vit.

Neni 3

Mbështetje për familjen që ofron shërbimin e kujdesit alternativ profesional në familje

1. Familjet kujdestare të regjistruara në Regjistrin Elektronik për Kujdesin Alternativ në Familje, që ofrojnë shërbimin e kujdesit alternativ profesional në familje, përfitojnë mbështetje financiare mujore në nivelin e pagës minimale të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Mbështetja financiare mujore jepet për aq kohë sa familja kujdestare profesionale është e regjistruar si ofruese e shërbimit dhe ka në kujdes alternativ në familje të paktën një fëmijë, sipas vendimit përkatës, me përjashtim të familjeve kujdestare profesionale të emergjencës, të cilat e përfitojnë pagesën sipas nenit 4 të këtij vendimi.
3. Mbështetja financiare përfitohet pasi prindi aplikues i familjes kujdestare profesionale punësohet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ka vendbanimin e përhershëm dhe lidh kontratë pune me këtë njësi.
4. Marrëdhëniet e punës ndërmjet njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe prindit aplikues të familjes kujdestare profesionale rregullohen në përputhje me Kodin e Punës në Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Zbatimi i masës financiare

1. Mbështetja financiare për fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje mbulohet nga buxheti i shtetit.
2. Përfitimi i mbështetjes financiare, sipas neneve 2 dhe 3 të këtij vendimi, fillon pas marrjes së vendimit gjyqësor për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ në familje dhe lidhjes së kontratës së punës ndërmjet prindit aplikues të familjes kujdestare profesionale dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore.
3. Në rastin e familjeve kujdestare profesionale të emergjencës, përfitimi i pagesës fillon në momentin e lidhjes së kontratës me njësinë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me parashikimet e këtij vendimi.
4. Mbështetja financiare e parashikuar në pikën 2 të këtij neni ndërpritet me përfundimin e ofrimit të shërbimit të kujdesit alternativ në familje.
5. Të dhënat për familjet kujdestare dhe fëmijët e vendosur në kujdes alternativ në familje, që përfitojnë mbështetje financiare sipas këtij vendimi, regjistrohen dhe administrohen në Regjistrin Elektronik të Kujdesit Alternativ në Familje, të integruar në regjistrin elektronik të shërbimeve shoqërore.

Neni 5

Informimi dhe raportimi

Njësitë e vetëqeverisjes vendore informojnë Shërbimin Social Shtetëror, nëpërmjet Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, për fillimin dhe përfundimin e ofrimit të shërbimit nga familjet kujdestare profesionale, si dhe për familjet kujdestare profesionale dhe fëmijët në kujdes alternativ në familje që përfitojnë mbështetje financiare sipas këtij vendimi.

Neni 6
Indeksi

Shërbimi Social Shtetëror merr masa për rishikimin periodik të masave të mbështetjes financiare sipas nenit 2 të këtij vendimi, me qëllim indeksimin çdo vit në bazë të indeksit të çmimeve të konsumit.

Neni 7
Ngarkimi për zbatim

Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi ministria përgjegjëse për çështjet sociale, ministria përgjegjëse për financat, Shërbimi Social Shtetëror dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

E D I R A M A